

USHQYERJA

1. Sa herë në 24 orë bëhet ushqyerja e një të porsalinduri:
 - a) 6 herë në ditë
 - b) 8 herë në ditë
 - c) Sa herë të dojë bebi
2. Kur fillon ushqyerja shtesë e bebit:
 - a) Pas 4 muajsh
 - b) Pas 6 muajsh
 - c) Pas 1 viti
3. Ushqyerje “ekskluzivisht” me gji do të quajmë kur bebi ushqehet :
 - a) Me qumështin e gjirit
 - b) Me qumështin e gjirit dhe ujë
 - c) Me qumështin e gjirit dhe një shtesë ushqim
4. Teknika më e mirë e ushqyerjes me gji është:
 - a) Ulur
 - b) Shtrirë
 - c) Në çdo lloj pozicioni të nënës
5. Sa kohë pas lindjes fillon ushqyerja me gji:
 - a) 2 orë pas lindjes
 - b) 6 orë pas lindjes
 - c) Direkt pas lindjes
6. Ushqyerja enterale quhet kur pacienti ushqehet nga infermieri në rrugë:
 - a) Venoze
 - b) Sondës gastrike
 - c) E kombinuar
7. Ushqyerja parenterale quhet kur pacienti ushqehet nga infermieri në rrugë:
 - a) Venoze
 - b) Orale
 - c) E kombinuar
8. Elementet ushqyes në sa kategori janë ndarë:
 - a) 2
 - b) 4
 - c) 6
9. Një ndër qëllimet e elementëve ushqimor është :
 - a) Formimi strukturor I trupit
 - b) Lidhja me ambjentin e jashtëm
 - c) Kujdeset për shëndetin
10. Malnutricioni është :
 - a) Marrja jo e mirë e ushqimit

- b) Nxjerrja jo e mirë e ushqimit
 - c) Marrja dhe nxjerrja jo e mirë e ushqimit
11. Dieta konvaleshente është dieta :
- a) Me ushqime të buta
 - b) Me ushqime të lëngëshme
 - c) Me të dyja së bashku
12. Dieta terapeutike është dieta me :
- a) Ushqime të buta
 - b) Ushqime të lëngëshme
 - c) E përshtatur sipas sëmundjes
13. Administrimi i oxigjenoterapisë realizohet nëpërmjet:
- a) Sondës nazo- gastrike
 - b) Sondës nazale
 - c) Kateterit venoz
14. Ulja e oreksit ose e dëshirës për tu ushqyer quhet:
- a) Nauze
 - b) Anorexi
 - c) Flatulence
15. Cila nga rrugët e mëposhtëme nuk është rrugë ushqyerje:
- a) Parenterale
 - b) Kateter nazal
 - c) Sonde nazo- gastrike
16. Gjatë periudhës së dimrit procesi metabolik:
- a) Ulët
 - b) Rritet
 - c) Ndikon nga gjinia
17. Metoda për të kontrolluar sondën nazo-gastrike:
- a) Tubi futet me anë të gastrostomies
 - b) Futet pak ajër me anë të një shiringe në sondë
 - c) Futet pak gjak me anë të një shiringe në sondë
18. Gastrostomia është :
- a) Futja e një kateteri nga hunda në stomak
 - b) Futja e një tubi në stomak nëpërmjet ndërhyrjes kirurgjikale
 - c) Futja e një tubi nga hunda në stomak me ndërhyrje kirurgjikale
19. Karbohidratet gjënden në :
- a) Patate
 - b) Fruta
 - c) Arra
20. Kush ndikon në përberësit e eritrociteve dhe në ruajtjen e qelizave në organizëm:
- a) Hekuri

- b) Calcium
 - c) Jodi
21. Kush është përbërësi natyror që ndihmon organizmin që në mënyrë aktive të kryej funksionin:
- a) Mineralet
 - b) Hekuri
 - c) Vitaminat
22. Në balancimin e hormoneve dhe mungesa e tijë shkaton hipertiroz
- a) Jodi
 - b) Mirelet
 - c) Vitaminat
23. Kur përgatit një pacient për bronkoskopi, infermierja duhet të këshillojë pacientin që të mos:
- a) Ecë
 - b) Bisedojë
 - c) Ushqehet
24. Infermierja po kujdeset për një fëmijë me sëmundjen celiac (malabsorbim). Si mundet infermierja të vlerësojë suksesin e terapisë ushqimore?
- a) Monitoro shenjat vitale çdo 4 orë
 - b) Monitoro pamjen, sasinë dhe numrin e të dalave jashtë
 - c) Duke matur nivelin e creatininës dhe azotemise
25. Cili veprim infermieror është esencial kur siguron ushqyerjen enterale të vazhduar?
- a) Ngritja e kokës së shtratit
 - b) Pozicionimi i pacientit në anën e majtë
 - c) Ngrohjen e formulës përpara se të administrohet
26. Një pacient ka të vendosur tubin nazogastrik. Si mundet që infermierja të administrojë medikamentet orale të këtij pacienti?
- a) Ngroh tabletat deri sa ato të shkrihen dhe më pas e derdh lëngun në tubin nazogastrik
 - b) Shtyp tabletat, i përgatit në formë lëngu dhe më pas i kalon në tubin nazogastrik
 - c) I shtyp tabletat, pluhurin e tabletave e kalon në tubin nazogastrik duke përdorur një solucion NaCl

27. Rezultati i cilit test laboratorik është treguesi më i rëndësishëm i kequshqyerjes së një pacienti me plagë operatore?

- a) Niveli i kaliumit
- b) Numri i lymphocyteve
- c) Niveli i albuminës

28. Një pacient i shtruar në spital po ushqehet me tub nazogastrik. Gjatë ushqyerjes bolus pacienti vomit (vjell) dhe fillon të mbytet. Cili është veprimi më i përshtatshëm që duhet të ndërmerret infermieri?

- a) Pastron rrugët ajrore të pacientit
- b) Qetëson pacientin
- c) Fillon ringjalljen kardio - pulmonare